| 40 | Ndërtimi I stacionit të Autobuseve | **0.00** | 0.00 | 0.00 | **40,000.00** | 40,000.00 | 0.00 | 80,000.00 | 80,000.00 | 0.00 |
| 41 | Ndërtimi dhe Asfaltimi i Rrugës Mehmet Uka - Deçan | 53,175.89 | 53,175.89 | 0.00 | **150,000.00** | 150,000.00 | 0.00 | 250,000.00 | 150,000.00 | 100,000.00 |
| 42 | Restaurimi dhe renovimi I monumenteve kulturore (Kulla, Mullinjë) | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 153,970.61 | 153,970.61 | 0.00 | 200,000.00 | 200,000.00 | 0.00 |

**Kategoria Ekonomike** – Investimet Kapitale - e prezantuar në detaje në tabelën më lart paraqet një komponentë të rëndësishme të buxhetit të komunës e cila ndonëse nuk përfaqëson pjesën më të madhe të shpenzimeve të përgjithshme buxhetore, mbetet me rëndësi të veçantë në aspektin e planifikimit, për Komunën e Deçanit. Kjo kategori e shpenzimeve në kuadër të shpenzimeve të rregullta buxhetore, ka potencialin më të madh për të nxitur rritjen ekonomike. Andaj, kjo kategori e shpenzimeve, edhe gjatë periudhës së ardhshme afatmesme, do të vazhdojë të jetë në funksion të krijimit të ambientit më të favorshëm për ngritje të pjesëmarrjes së sektorit privat, përmes përmirësimit të vazhdueshëm të infrastrukturës. Përderisa ndikimi i këtyre investimeve në punësim dhe konsumi është relativisht i shpejtë, ndikimi i plotë i tyre në ekonomi do të mund të realizohet vetëm në periudhën afatmesme. Në këtë kontekst, përmirësimi i infrastrukturës do të pozicionojë ekonominë e Komunës së Deçanit në një rrugë të rritjes më të shpejtë dhe të qëndrueshme ekonomike në periudhën afatgjatë.

# 4. Analiza Gjinore

Komuna nuk ka përgatitur një buxhet të përgjegjshëm gjinor të detajuar, por është përpjekur për të vlerësuar se si shpenzimet kapitale janë ndarë për të adresuar çdo pabarazi gjinore në planifikimin e ardhshëm buxhetor. Ne kemi analizuar numrin e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave në kuadër të komunës, dhe po paraqesim këtë informacion në tabelën e mëposhtme:

Tabela 10:

| Kategoria | Shifrat sipas Regjistrimit të Popullsisë 2011 | % | Statistikat e fundit komunale 2020 | % |
|---|---|---|---|---|
| Gra | 20010 | 49 | 0 | 0 |
| Burra | 20140 | 51 | 0 | 0 |
| Vajza | X | | | |
| Djem | X | | | |
| Popullata e përgjithshme | 40150 | 100 | | |

Komuna i ka përdorur më pas të dhënat specifike gjinore që janë në dispozicion për të vlerësuar ndikimin gjinor të projekteve kapitale në kuadër të buxhetit të 2025-2027. Për shembull, kur një projekt është për një fshat ose lagje të caktuar, për një rrugë, gypat e ujësjellësit, qendër shëndetësore etj., ne kemi përdorur të dhënat e ndarjes së popullsisë në mes të grave, burrave, vajzave dhe djemve për atë zonë; Kur një projekt është për një shkollë të veçantë, ne kemi përdorur numrat e nxënësve: meshkuj dhe femra; Kur një projekt ndikon në tërë komunën (duke përfshirë projektet për administratën komunale), ne përdorim analizën e përgjithshme të popullsisë të viti 2011.

Tabela 11: Shpenzimet Komunale për (vitin e 1-3) 2025-2027

| Projektet | Gjithsej € | Shuma € 2025 (vitin e 1) | Shuma € 2026 (vitin e 2) | Shuma € 2027 (vitin e 3) | % e vlerësuar e shpenzuar në vajza dhe gra | % e vlerësuar e shpenzuar në djem dhe burra |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Projekti për ...Gra | 60,000 | 10,000 | 20,000 | 30,000 | | |
| Projekti për ...Rini | 80,000 | 20,000 | 30,000 | 30,000 | | |
| Bursa për Studentët | 200,000 | 60,000 | 70,000 | 70,000 | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| | | | | | | |
| Gjithsej € | 340,000 | 90,000 | 120,000 | 130,000 | | |

# IV. Korniza e Performancës së Shpenzimeve

Kapitulli i Performancës së Shpenzimeve Komunale është hartuar për herë të parë në ciklin buxhetor 2016-2018. Indikatorët/Treguesit matës të më poshtëm janë hartuar në konsultim dhe me kontributin e drejtorëve / menaxherëve kryesor të programeve komunale. Indikatorët apo treguesit e më poshtëm të përformancës janë hartuar karshi fushave dhe objektivave prioritare të Komunës për periudhën afatmesme 2024-2026 (të renditur në fillim të këtij dokumenti) dhe në këtë mënyrë janë dhënë vlerat matëse. Njësia matëse e Treguesve është e ndryshme dhe më poshtë ka një ndërthurje të treguesve cilësorë me treguesit sasiorë.

Meqë ky është cikli i parë buxhetor ku matësit e performancës janë zhvilluar, jo të gjithë matësit e mundshëm i kanë vlerat e tyre, por Komuna përmes sektorëve të ndryshëm do të punojë drejt zhvillimit të tyre dhe grumbullimit të matësve përkatës në ciklet e ardhshme buxhetore.

Më poshtë do jepet ndarja e synimeve (Objektivave Strategjikë) në Objektiva dhe për secilin nga objektivat do paraqiten Treguesit e Performancës të cilët bëjnë të mundur që të matet realizimi i Objektivit përkatës.

Së fundi, në tabelat e mëposhtme përveç synimeve strategjike, objektivave përkatëse dhe treguesve matës, janë paraqitur edhe vlerat buxhetore ose shpenzimet që janë paraparë karshi realizimit të këtyre synimeve. Vëreni se vlerat e përshkruara në formë tabelare përfshijnë vetëm kategorinë ekonomike – investime kapitale – ndonëse komuna planifikon edhe shpenzime në katër kategoritë tjera ekonomike që lidhen me këto synime. Përfshirja edhe e kësaj pjese buxhetore (përveç buxhetit kapital) do të provohet të bëhet në ciklet e tjera buxhetore si fazë e dytë e avancimit tutje të matësve të performancës në buxhetin afatmesëm komunal.

**1. Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi për të gjithë**

| OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TE KOMUNES | Indikatorët për Matjen e Performancës në drejtim të përmbushjes së Objektivave | 2024 (vlera bazë)[2] | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|---|---|
| Përmirësimi i standardëve të arsimimit dhe nivelit të arritjes (pajisje shkollore, renovime shkollore dhe permirësim, bursa për studime, laboratore) | • Numri i nxënësve që përfitojnë nga kabinete të plotësuara (kabinete apo laboratorë informatike, biologjie etj | 300 | 450 | 550 | 650 |
| | • | | | | |
| | • Numri i nxënësve që përfitojnë nga përmirësimi i infrastrukturës dhe kushteve të shkollave. | 2500 | 2400 | 2300 | 1800 |

[2]Vlerabazëmbitë cilën do të bëhet matja e përformancës është viti 2015, pasi që në këtë vit për herë të parë, Komuna ka ndërmarrë Iniciativen për zhvillimin e treguesve të performancës.

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | • norma e nxënësve ngelës në arsimin e fillor | 5.4 | 4.5 | 4.2 | 3.7 |
| | • norma e nxënësve ngelës në arsimin e mesëm | 3.7 | 3.8 | 3.9 | 3.9 |
| | • Mirëmbajtja e objekteve shkollore për m2 | 2350 | 2450 | 2560 | 2770 |
| | • Studentët në nevojë që marrin bursa | 0 | 0 | 0 | 50 |
| | • | | | | |
| | • Përfshirja e nxënësve në arsimin e obligueshëm me qëllim të zhdukjes së analfabetizmit | 12% | 10% | 8% | 6% |
| | • Shkalla e lënies së shkollimit | 1% | 1% | 1% | 1% |
| Mbështetje direkte e sektorit bujqësor dhe blegtoral | • Nevoja për pajisje bujqësore të plotësuara (numri i bujqëve të pajisur me pajisje bujqësore) | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | • Nevojat e plotësuara në sektorin e Lavërtari, Pemtarisë, Perimtarisë (numri i bujqëve të ndihmuar) | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | • Nevojat e plotësuara në fushën e Blegtorisë (numri i fermerëve përfitues) | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | • Rastet e urgjencës si pasojë e sëmundjeve të ngjitura nga qentë apo kafshimeve të qenëve endacakë | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | • Numri i krerëve të përhapjes së një sëmundje tek kafshët | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | • Rritja e siperfaqeve bujqësor në sera | 5ha | 5ha | 5ha | 5ha |
| | • Përqindje e krerëve të ngordhur për shkak të sëmundjeve | 1% | 1% | 1% | 1% |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | • Panaire rajonale të zhvilluara | 2 | 2 | 2 | 2 |

Për synimin e parë, Komuna e Deçanit ka identifikuar dy Objektiva, të cilët kanë të bëjnë me sektorin e arsimit dhe me sektorin e bujqësisë dhe blegtorisë. Në realizimin e synimit të parë janë të përfshira Drejtoria e Arsimit, ndërsa në realizimin e Objektivit të dytë të këtij synimi është përfshirë Drejtoria për Bujqësi.
Buxheti total (kategoria ekonomike – investime kapitale) në dispozicion të Synimit të parë jepet në tabelën e mëposhtme.

| | Burimet buxhetore (000 Euro) | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
| Synimi (Objektivi strategjik): **Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi për të gjithë** | | | | |
| Objektivi 1: Përmirësimi i standardeve të arsimimit dhe nivelit të arritjes (pajisje shkollore, renovime shkollore dhe permirësim, bursa për studime, laboratore) | 50.000 | 70.000 | 70.000 | 70.000 |
| Objektivi 2: Mbështetje direkte e sektorit bujqësor dhe blegtoral | 50.000 | 30.000 | 50.000 | 50.000 |

2. **Përmirësimi i Shëndetësisë dhe Mirëqenies së Qytetarëve**

| OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TE KOMUNES | Indikatorët për Matjen e Performancës në drejtim të përmbushjes së Objektivave | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|---|---|
| Asistenca sociale për familjet në nevojë, pa të ardhura/të ardhura të ulëta | • numri i familjëve të ndihmuara me mjete financiare (familje pa të ardhura) | 30 | 30 | 30 | 30 |
| | • familje të varfra që përfitojnë nga Komuna pagesën e kostos së strehimit | 4 | 4 | 6 | 6 |
| | • numri i familjëve në nevojë, me të ardhura të ulëta të ndihmuara me mjete financiare | 30 | 30 | 30 | 30 |
| | • familje në nevojë të ndihmuara me pako ushqimore | 100 | 100 | 100 | 100 |
| | • familjet në nevojë që përfitojnë furnizim me dru | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve | • Pika shëndetësore (QMF) me kushte të përmirësuara dhe të | 15 | 15 | 15 | 15 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile | mirëpajisura | | | | |
| | • Raporti banorë që u ofrohet shërbimi shëndetësor/ QMF | 2000 | 2000 | 2000 | 2000 |
| | • norma e fëmijëve 0 – 6 vjeç të vaksinuar (%) | 92% | 95% | 95% | 95% |
| | • rastet e pacientëve të sëmurë me sëmundje gjaku (që kanë nevojë për hemodializë) të shërbyera | 16 | 15 | 15 | 15 |
| | • norma banorë / mjek | 1500/1 | 1500/1 | 1500/1 | 1500/1 |
| | • % e nxënësve të klasave I-IX të kontrolluar në mënyrë sistematike | 95% | 95% | 95% | 95% |
| | • përqindja e banorëve të vaksinuar | 24% | 45% | 45% | 45% |
| | • rastet e pacientëve me gjendje të rëndë ekonomike që përfitojnë barna | 1000 | 1500 | 1500 | 1500 |
| | • Numri i familjëve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës që subvencionohen | 1200 | 1200 | 1200 | 1200 |
| Promovimi i projekteve për rini dhe kulturë, dhe ofrimi i terreneve të reja sportive | • të rinj të angazhuar në aktivitete kulturore | 300 | 400 | 500 | 500 |
| | • qytetarë që kanë në dispozicion infrastrukturën sportive në vendbanimet e tyre | 300 | 400 | 500 | 500 |
| | • të rinj të angazhuar në aktivitete sportive | 500 | 700 | 800 | 800 |

Për synimin e Dytë, Komuna e Deçanit ka identifikuar tre Objektiva, të cilët kanë të bëjnë me mbështetjen sociale të grupeve në nevojë, me sektorin e shëndetësisë dhe me mbështetjen e Rinisë, Sportit dhe Kulturës. Në realizimin e synimit të dytë janë të përfshira Drejtoria Shëndetësisë dhe Mirëqeniës Sociale, Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sporteve dhe Zyra e Kryetarit.
Buxheti total (kategoria ekonomike – investime kapitale) në dispozicion të Synimit të dytë jepet në tabelën e mëposhtme.

| | Burimet buxhetore (000 Euro) | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
| Synimi (Objektivi strategjik): **Përmirësimi I Shëndetësisë dhe Mirëqenies së Qytetarëve** | | | | |
| Objektivi 1: Asistenca sociale për familjet në nevojë, pa të ardhura/të ardhura të ulëta | x | X | x | X |
| Objektivi 2: Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shëndetësisë mobile | x | X | x | X |
| Objektivi 3: Promovimi i projekteve për rini dhe kulturë, dhe ofrimi i terreneve të reja sportive | 25000 | 30000 | 30000 | 30000 |

### 3. Përmirësimi i Ambientit të Komunës dhe Qëndrueshmëria e Tij

| OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TE KOMUNES | Indikatorët për Matjen e Performancës në drejtim të përmbushjes së Objektivave | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|---|---|
| Përmirësimit dhe rigjenerimit të infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriqimi publik dhe numerizimi); transportit; dhe kanalizimit | • km rrugë lokale të ndërtuara | 15 | 10 | 10 | 10 |
| | • km rrugë lokale të mirëmbajtura (në verë dhe në dimër) | 140 | 140 | 140 | 140 |
| | • Km rrugë lokale të asfaltuara (të rehabilituara) | 25 | 30 | 30 | 30 |
| | • Përqindja e familjëve dhe biznesëve në zonën urbane të lidhura me rrjetin e ujësjellësit (familje dhe biznese që lidhen me rrjetin e ujësjellësit) | 85% | 87% | 89% | 91% |
| | • Numri i vendbanimeve të reja të lidhura me rrjetin e ujësjellësit | 10 | 5 | 5 | 5 |
| | • Numri i venbanimeve të reja të lidhura me rrjetin e kanalizimeve | 7 | 4 | 5 | 5 |
| | • Km sipërfaqe publike me ndriçim të përmirësuar | 10 | 5 | 5 | 5 |
| | • % e banorëve të komunës të përfshirë në transportin publik | 35% | 35% | 35% | 35% |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | • Km rrugë me sinjalistikë (vertikale dhe horizontale) të përmirësuar | 25 | 30 | 30 | 30 |
| | • Aksidente me pasoja të rënda në rreth rrotullime, kryqëzime apo segmente rrugore të njohura si problematike | 15 | 10 | 10 | 10 |
| | • Orë ujë të pijshëm në ditë/ Furnizimi me ujë të pijshëm në ditë | 24 | 24 | 24 | 24 |
| | • Niveli i klorit/ m3 ujë të pijshëm | Xmg | xmg | xmg | Xmg |
| | • % e faturimit të ujit të pijshëm të prodhuar | 85% | 85% | 85% | 85% |
| Përmirësim i standardeve ambientale | • % e ekonomive familjare që kanë qasje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave | 85% | 85% | 85% | 95% |
| Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara | • m2 sipërfaqe e gjelbëruar për banor | 2 | 3 | 3 | 3 |

Për Synimin e tretë, Komuna e Deçanit ka identifikuar tre Objektiva, të cilët kanë të bëjnë me infrastrukturën publike (rrugët, ujësjellësit, kanalizimet), me ambientin dhe me mbështetjen e shtimit të sipërfaqeve të gjelbëruara. Në realizimin e synimit të tretë më së shumti është e përfshirë Drejtoria për Shërbime Publike dhe Zyra e Kryetarit. Buxheti total (kategoria ekonomike – investime kapitale) në dispozicion të Synimit të tretë jepet në tabelën e mëposhtme.

| | Burimet buxhetore (000 Euro) | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
| Synimi (Objektivi strategjik): **Përmirësimi I Ambientit të Komunës dhe Qëndrueshmëria e Tij** | | | | |
| Objektivi 1: Përmirësimit dhe rigjenerimit të infrastrukturës rrugore (sinjalizimi horizontal e vertikal, ndriqimi publik dhe numerizimi); transportit; dhe kanalizimit | 300.000 | 300.000 | 400.000 | 400.000 |
| Objektivi 2: Përmirësim i standardeve ambientale[3] | 20000 | 30000 | 30000 | 30000 |

[3]Komuna nuk ka alokuar buxhet në lidhje me këtë synim duke llogaritur se Kompania respektive e grumbullimit të mbeturinave vetëfinancohet dhe në planet e saja ka të paraparë buxhet sa I përket zgjerimit të rrjetit dhe ofrimit të qasjes së më shumë qytetarëve në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave si një ndër treguesit themelor të përdorur këtu.

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Objektivi 3: Ofrimi i më shumë hapësirave të gjelbëruara | 30000 | 40000 | 40000 | 40000 |

## 4. Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve.

| OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TE KOMUNES | Indikatorët për Matjen e Performancës në drejtim të përmbushjes së Objektivave | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|---|---|
| | • Koha mesatare për lëshimin e certifikatave të gjendjes civile | 14min/për copë<br>658 certifikata të lëshuara | 14min/për copë<br>700 certifikata të lëshuara | 13.2min/për copë<br>750 certifikata të lëshuara | 12.5min/për copë<br>780 certifikata të lëshuara |
| | • Numri i banorëve të komunës që i marrin shërbimet nga zyrat e gjendjes civile/zyrë të gjendjes civile | 12000 | 13000 | 13000 | 13000 |

Për Synimin e katërt, Komuna e Deçanit ka identifikuar vetëm një Objektiv, i cili ka të bëjë me përmirësimin e shërbimeve që Komuna u ofron qytetarëve. Në realizimin e synimit të katërt janë të përfshira Drejtoria e Shërbimeve Publike, Zyra e Kryetarit.
Buxheti total (kategoria ekonomike – investime kapitale) në dispozicion të Synimit të katërt jepet në tabelën e mëposhtme.

| | Burimet buxhetore (000 Euro) | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
| Synimi (Objektivi strategjik):<br>**Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve** | | | | |
| Objektivi 1: Ndërtimit dhe rikonstruktimit të zyrave komunale gjendjes civile) në pika më të afërta të vendbanimeve, më qëllim të ofrimit të shërbimeve | X | X | X | X |

Nga tabelat e mësipërme mund të thuhet se buxheti i komunës së Deçanit (kategoria ekonomike – investime kapitale) është ndarë ndërmjet synimeve të komunës si më poshtë:

| | Burimet buxhetore (000 Euro) | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 2024 | 2025 | 2026 | 2027 |
| Synimi (Objektivi strategjik):<br>**Forcimi i Ekonomisë Komunale me mundësi për të gjithë** | 50 | 60 | 70 | 80 |
| Synimi (Objektivi strategjik):<br>**Përmirësimi I Shëndetësisë dhe Mirëqenies së Qytetarëve** | 40 | 40 | 40 | 50 |
| Synimi (Objektivi strategjik):<br>**Përmirësimi I Ambientit të Komunës dhe Qëndrueshmëria e Tij** | 50 | 40 | 40 | 40 |
| Synimi (Objektivi strategjik):<br>**Krijimi i qeverisë komunale që ofron shërbime efikase dhe që u përgjigjet kërkesave të qytetarëve** | 30 | 30 | 30 | 30 |

# 5. DEKLARATA PËR MISIONIN DHE PERFORMANCËN SIPAS DREJTORIVE

## 5.1. Zyra e Kryetarit

**Misioni**: Kryetari i komunës, përfaqëson komunën dhe vepron në emër të sajë, udhëheqë ekzekutivin e komunës, administratën dhe mbikëqyr menaxhimin financiar të komunës duke ushtruar të gjitha kompetencat, ekzekutive të Kuvendit të Komunës, organizon punën dhe drejton politikën e komunës; emëron dhe shkarkon drejtorët e drejtorive; propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në Kuvendin e Komunës; propozon zhvillimin komunal, planet rregullative e investuese, propozon buxhetin komunal vjetor për miratim në Kuvendin e komunës dhe ekzekuton buxhetin e miratuar, raporton para kuvendit të komunës për situatën ekonomiko – financiare dhe për zbatimin e planeve investuese të komunës; si dhe ndërmerr aktivitetet e tjera që i caktohen me statut, rregullore komunale apo akte të tjera ligjore dhe nën ligjore të cilat janë në fuqi.

**Vizioni**: Zhvillimi lokal ekonomik; planifikim urban e rural; shfrytëzimi i tokës dhe zhvillimit; mbrojtje e mjedisit lokal; ofrimi i shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë furnizimin me ujë, kanalizimin, trajtimin e ujërave të zeza, menaxhimin e mbeturinave, rrugëve lokale; përgjigjije ndaj rastëve emergjente lokale; ofrimin sa më të mirë të arsimit publik parashkollor, fillor dhe të mesëm, ofrimin e për kujdesit primar publik shëndetësor; ofrimin e mirëqenies sociale, përfshirë rritjen e nivelit të barazisë gjinore në të gjitha fushat, ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike; turizmin, aktivitetet kulturore dhe të lira etj.

**Qëllimi**: Është që të gjitha kompetencat e komunës të rregulluara me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutin e Komunës të zbatohen në përpikmëri në mënyrë që misioni i komunës të shënoj shkallë sa më të lartë të performancës duke i realizuar me sukses qëllimet strategjike komunale.

| Viti | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|
| Kuantitative:<br>Përgatitja e të gjitha materialeve përmbledhjet e Kuvendit komunal, në sferën e legjislacionit të nivelit te qeverisjes lokale (nxjerrja e rregulloreve, vendimeve, udhëzimeve) që kanë të bëjnë me një qeverisje sa më të mire të të gjitha drejtorive të Komunës dhe gjithnjë në shërbim të gjithë qytetarëve të Komunës. | Mbajtja e mbledhjeve sipas afateve kalendarike të planit vjetor. | Mbajtja e mbledhjeve si pas afateve kalendarik të planit vjetor. | Mbajtja e mbledhjeve sipas afateve kalendarike të planit vjetor. |
| Kualitative:<br>1. Mbledhjet e rregullta me drejtoret e drejtorive;<br>2. Mbledhjet e rregullta me KKSB-në;<br>3. Mbledhjet e rregullta me administratorët e fshatrave dhe lagjeve të Komunës së Deçanit | 48<br>12<br><br>6 | 48<br>12<br><br>6 | 48<br>12<br><br>6 |
| | | | |

## 5.2. Zyra e Kuvendit

**Misioni:**
Kuvendi i Komunës është organi më i lart legjislativ i zgjedhur në mënyrë të drejtpërdrejtë nga qytetarët në pajtim me Ligjin mbi zgjedhjet lokale.
Kuvendi i Komunës mund të miratoj aktet dhe të ndërmarrë masa për zbatimin e tyre brenda fushës së kompetencave të tyre e që vlejnë brenda territorit të komunës dhe në përputhje me sistemin kushtetues dhe ligjor të Republikës së Kosovës, dhe atë: statutin e komunës; rregulloren e punës; rregulloret komunale; dhe çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionimin e komunës.

**Vizioni:**
Për të siguruar shqyrtimin në kohë dhe Miratimin e politikave dhe rregulloreve komunale dhe planeve statutore, duke përfshirë buxhetin, në një mënyrë e cila i lejon ekzekutivit dhe stafit të komunës për të kryer

detyrën e tyre në mënyrë efikase dhe efektive. Për të siguruar politikë të përshtatshme dhe plane brenda fushëveprimit të kompetencave të Komunës, duke i respektuar të gjitha ligjet, në një mënyrë që përfitimet e qytetarëve të jenë të mëdha.

**Objektivat:**

- Shqyrtimi dhe miratimi në kohë i politikave/rregulloreve të reja;
- Shqyrtimi dhe miratimi në kohë i të gjitha planeve statutore (duke përfshirë buxhetin)
- Përmbushja e nevojave të qytetarëve përbrenda burimeve në dispozicion të komunës.

| Indikatori | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|
| % e akteve legjislative të publikuara në faqen e internetit të komunës brenda 1 jave pas miratimit | caku për vitin 2025 | caku për vitin 2026 | caku për vitin 2027 |
| % i vendimeve të kuvendit të publikuara në faqen e internetit të komunës brenda periudhës 2 dite pas mbledhjes së kuvendit | 100 | 100 | 100 |

## 5.3. Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

__Misioni:__ Udhëheq dhe menaxhon me të gjitha çështjet administrative - teknike të drejtorisë dhe ato të SHCK-së që bien në këtë kompetencë, udhëheq me librat amë të gjendjes civile, lëshon certifikata të gjendjes civile, sjell akt vendime për regjistrime të më vonshme, korrigjime - ndryshime të emrit apo mbiemrit personal, harton aktet normative që bien në kompetencë të drejtorisë, udhëheq punën e arkivit komunal, qendrën për shërbim të qytetarëve, sektorin teknik dhe të mirëmbajtjes, angazhohet dhe përcjellë punën e bashkëpunimit të komunës me vendbanimet dhe fshatrat si dhe punë tjera që bien në kompetencë të drejtorisë. Përmirëson nivelin e barazisë gjinore brenda administratës së komunës.

__Vizioni:__ Administrata siguron të gjitha shërbimet administrative për Kryetarin dhe Kuvendin, procedurat e menaxhimit të stafit të shërbimit civil, gjithashtu menaxhon me stafin dhe buxhetin e kësaj drejtorie.

__Qëllimi:__ Menaxhimi dhe ngritja e nivelit të lartë në administratën komunale, si dhe ngritja e kapaciteteve dhe shërbimeve më cilësore për qytetarët .

**Performancë:**

| | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|
| **Kuantitative**<br>Realizimi i të gjitha detyrave dhe objektivave që rrjedhin nga statuti i komunës, aktet tjera normative komunale, ligjet, udhëzimet e organeve më të larta, rritja e vëllimit të punës në të gjitha sektorët dhe njësitë varësisht nga situatat dhe nevojat | Gjatë | Gjatë | Gjatë gjithë |

| | | | |
|---|---|---|---|
| e punës së shtuar sipas sezonave, nevojave apo ndryshimet eventuale në programe dhe kompetencat eventuale që mund ti barten drejtorisë dhe sektorëve të saj. Të gjitha këto kërkojnë edhe përcjelljen me koston e shpenzimeve buxhetore. | gjithë kohës | gjithë kohës | kohës |
| **Kualitative** | **2025** | **2026** | **2027** |
| Puna rreth certifikimit do të bëhet sipas programit unik të Kosovës, ku do te kemi një përmisim të kualitetit në shërbimet e karakterit civil. | 100% | 100% | 100% |

## 5.4. Drejtoria Për Buxhet dhe Financa

**Misioni:** Misioni i kësaj drejtorie është menaxhimi i buxhetit dhe financave të Komunës, që d.m.th.:

- Siguron drejtoritë me shërbimet e kontabilitetit dhe menaxhimin e shpenzimeve dhe zhvillimin ekonomik;
- Informon liderët komunalë me aktualitetet e ndërlidhura me buxhetin e Komunës;
- Përgatit rregulloret për KPF,
- Bënë menaxhimin e financave komunale;
- Bënë përgatitjen e prezantimit të buxhetit;
- Koordinon punët dhe aktivitetet e drejtorisë;
- Këshillon zyrtarët komunal për procedurat dhe rregullat në lidhje me buxhetin dhe financat.

**Vizioni:** Përgatit rregulloret për Komitetin për Politikë dhe Financa dhe për Kuvend lidhur me menaxhimin e financave komunale, përgatitjen dhe prezentimin e buxhetit, kërkesat buxhetore tjera, Pasqyrat vjetore financiare dhe koordinimin e punëve dhe aktivite te vetë drejtorisë, këshillon zyrtarët komunal për procedurat dhe rregullat në lidhje me buxhetin.

**Qëllimi:** Përgatitja dhe harmonizimi i akteve ligjore dhe parakushteve e tjera përshtimin e efikasitetit në realizimin e të hyrave buxhetore.

**Performancë:**

| Kuantitative | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|
| 1. Përgatitja e raporteve buxhetore mbi të hyrat; | 14 | 14 | 14 |
| 2. Përgatitja e raporteve buxhetore mbi shpenzimet; | 14 | 14 | 14 |
| 3. Rishikim, rialokim dhe transfere buxhetore; | 2 | 2 | 2 |
| 4. Zotime në sistemin e SIMFK-së (Frebalance); | 1,300 | 1,330 | 1,370 |
| 5. Fatura tatimore mbi tatimin në pronë; | 2,900 | 2,926 | 2,950 |
| 6. Kërkesa dhe ankesa rreth matjeve të pronave; | 100 | 105 | 120 |
| 7. Lëndë të ndryshme me kërkesa; | 150 | 160 | 170 |
| 8. Raportet e punës së drejtorisë dhe stafit; | 2 | 2 | 2 |
| 9. Programi i punës së drejtorisë dhe stafit; | 2 | 2 | 2 |
| 10.Çertifikime, aprovime dhe shpenzime të UZP-ve. | 1,300 | 1,330 | 1,370 |
| 11. Integrimi i Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor në KAB çdo vit. | 1 | 1 | 1 |

| Kualitative | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1.Të hyrat e realizuara nga tatimi në pronë do të shpenzohen në realizimin e projekteve kapitale.<br>2. Menaxhimi me efiqient i buxhetit dhe ekzekutimi i tij sipas dinamikës së planifikuar të rrjedhjes së parasë së gatshme. | 100% | 100% | 100% |

## 5.5. Drejtoria Për Mbrotje Shpetim dhe Shërbimeve Publike

**Misioni:**
1. Mbikëqyr dhe bashkëpunon me kompanitë shërbyese të Komunës, të higjienës dhe furnizimit me ujë;
2. Menaxhon dhe mirëmban të gjitha sheshet publike që i përkasin komunës si dhe përkujdesjen për mirëmbajtjen e varrezave të Dëshmorëve;
3. Bashkëpunon me institucionet, organizatat joqeveritare dhe të gjithë mekanizmat tjerë në raste të fatkeqësive elementare;
4. Menaxhon, organizon dhe administron me sektorët dhe shërbimet në kuadër të saj, sipas kuadrit të saj, sipas instruksioneve administrative e të direktivave operative për çfarëdo çështje që ka të bëjë me funksionet dhe përgjegjësitë e DSHPE-së.

**Vizioni:** Realizimi i suksesshëm i planit për parandalimin e emergjencave, reagimin e shpejtë dhe të suksesshëm ndaj emergjencave, intervenime të suksesshme të shërbimit të zjarrfikësve dhe shpëtimit, rritjen e performancës në shërbimin e zjarrfikësve dhe shpëtimit, mirëmbajtja e pastërtisë së qytetit, ndriçimi elektrik i qytetit dhe i tërë zonës urbane, kanalizimit dhe mbeturinave duke bashkëpunuar ngusht me kompaninë lokale të mbeturinave.

**Qëllimi:** Menaxhimi dhe organizimi i situatave të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive tjera, menaxhimi i mbeturinave dhe furnizim me ujë të pijshëm, mirëmbajtjen e ndriçimit publik, mirëmbajtjen e rrugëve lokale në të gjitha vendbanimet gjatë sezonit veror - dimëror, mirëmbajtjen e kanalizimit fekal dhe atmosferik me kompanitë e kontraktuara etj.

| Indikatori | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|
| % e rrugëve të asfaltuara | caku për vitin 2025 | caku për vitin 2026 | caku për vitin 2027 |
| Km-të e trotuareve të ndërtuara | 15 | 15 | 20 |
| % e ekonomive familjare me qasje në ujë të pijshëm | 65 | 70 | 80 |
| % e ekonomive familjare të lidhura në sistemin e kanalizimit | 55 | 65 | 75 |
| % e inspektimeve për siguri nga zjarri ku nuk janë gjetur shkelje | 55 | 75 | 85 |

## 5.6. Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale

**Misioni:** Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale siguron zbatimin e kujdesit parësor shëndetësor në

ofrimin e shërbimeve shëndetësore nëpërmjet zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare duke përfshirë promovimin dhe edukimin shëndetësor, parandalimin, zbulimin e hershëm/diagnostifikimin, mjekimin/kujdesin dhe rehabilitimin e të lënduarit, të sëmurët me sëmundje akute dhe kronike, shëndetin oral, furnizimin me barna, kujdesin antenatal, kujdesin posnatal, planifikimin familjar, kujdesin paliativ, ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit, ofrimin e shërbimeve cilësore të sigurta, me qasje të lehtë, të barabartë për të gjithë.
QPS-së siguron ofrimin e përkujdesit për rastet sociale si dhe ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për të gjithë qytetarët brenda territorit të komunës.

**Vizioni:** Në drejtorinë tonë ne punojmë për të zbatuar legjislacionin përkatës shëndetësor për të siguruar që shërbimet e mëposhtme primare shëndetësore për të gjithë qytetarët ofrohen në fushat e mjekësisë familjare, pediatrisë, gjinekologjisë, stomatologjisë, farmacisë, shërbimet laboratorike dhe kujdesin mjekësor emergjent. Ne i ofrojmë këto shërbime duke punësuar staf profesional dhe duke e trajnuar stafin mjekësorë që vepron në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe një numër të klinikave familjare tjera që i ofrojnë këto shërbime. Përveç kësaj, ne gjithashtu do të punojmë për të siguruar nivelet e duhura të higjienës, që nga kryerja e inspektimeve sanitare për ujin e pijshëm, bizneset prodhuese, përpunimin ose shitjen e ushqimit, dhe atyre kompanive që merren me trajtimin e mbeturinave. Ne gjithashtu synojmë për të siguruar mbështetje të shërbimit social në pikat më të rrezikuara të bashkësisë sonë. Ne e bëjmë këtë përmes identifikimit të rasteve sociale, dhe këtë e bëjmë duke vlerësuar nevojën rast për rast.
QPS-së kujdeset që banorëve brenda territorit të Komunës t'iu ofroj: përkujdes dhe mirëqenie sociale, këshillime gjithëpërfshirëse dhe efikase, zbatim i rregulloreve, identifikim të familjeve skamnore, përkujdesje ndaj fëmijëve e me theks të veçantë përkujdesje ndaj fëmijëve jetim, vendosja e kujdestarisë, bashkëpunimi me OJQ, bashkëpunimi me Gjykata, Policinë, Shkolla etj.

**Qëllimi:** Përmirësimi i shëndetësisë dhe mirëqenies së qytetarëve;
Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve shëndetësore, përmirësimi i ofrimit të shëndetësisë mobile për një komunitet të shëndetshëm;
Arritja e rezultateve më të larta në ofrimin e shërbimeve dhe përkujdesje për të gjithë qytetarët nga QPS-ja.

**Performancë:**

| Indikatori | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|
| % e rrugëve të asfaltuara Raporti i numrit të qytetarëve me numrin e objekteve të kujdesit shëndetësor primar | caku për vitin 2025 | caku për vitin 2026 | caku për vitin 2027 |
| % e fëmijëve nën moshën 1 vjeçar që e përfundojnë rrethin e parë të imunizimit | 85 | 95 | 95 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Rinovimi i objekteve shëndetësore; % e zbatimit të planit 3 vjeçar për përmirësimin e objekteve shëndetësore | 55 | 65 | 75 |
| Raporti i numrit të doktorëve me numrin e qytetarëve | 1/1500 | 1/1500 | 1/1500 |
| % fëmijëve shkollor që kryejnë kontrolla dentare përmes vizitave në shkolla të dentistëve | 35 | 40 | 50 |
| % e shkollave që marrin pjesë në fushatën për vetëdijesimin dentar | 55 | 60 | 70 |
| % e uljes së sëmundjeve specifike të fëmijërisë | 35 | 40 | 50 |

## 5.7. Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mjedisit

**Misioni:** Shqyrtimi i të gjitha kërkesave të aplikuesëve dhe zgjidhja e tyre konform ligjeve në fuqi dhe vendimeve të komunës, ofrimi i shërbimeve të shpejta dhe kualitative për qytetarët, përgatitja e raporteve dhe planeve të punës për drejtorinë;
Mjedis më tërheqës natyror dhe përdorim më efektiv i tokës dhe ndërtesave.

**Vizioni:** Me mbajtjen e regjistrit të saktë të tokës, të dhënave kadastrale, hartave dhe tokës tjetër dhe ndërtimin e bazave të të dhënave të ndërlidhura, ne përpiqemi për të zhvilluar plane rregullore për përdorimin më efektiv dhe efikas të tokës dhe ndërtesave në gjithë komunën e Deçanit. Duke bashkëpunuar ngushtë me Drejtoritë e tjera, ne dëshirojmë të sigurojmë dhe arrijmë obligime statusore dhe ligjore, duke bërë që ato të jenë përmbushur në përputhje me planet e zhvilluara Urbane, dhe Planet Hapësinore dhe aktiviteteve për mbrojtjen e mjedisit. Me lëshimin e lejeve të ndërtimit dhe kryerjen e inspektimeve, ne dëshirojmë që të sigurohet që zhvillimi dhe ndërtimi të jetë në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore. Brenda kësaj drejtorie ne gjithashtu menaxhojmë shpronësimin e tokës për të lehtësuar zbatimin në kohë dhe efektiv të projekteve të zhvillimit të infrastrukturës. Përveç kësaj, ne ofrojmë rregullore në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe të promovojmë respektimin e mjedisit dhe turizmit për të krijuar një komunë me ambient të pastër, të gjelbër dhe më tërheqës për vizitorë.

**Qëllimi:** Përmes implementimit të PZHK-së, PZHU-së, PRRU-së dhe Hartave zonale të ndërtojmë Komunën, të mbrojmë mjedisin si dhe të rrisim të hyrat buxhetore komunale. Inkurajim dhe mbështetje e grave për të regjistruar pronën.

**Performancë:**

| Indikatori | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|
| Koha për lëshimin e lejes ndërtimore | | | |
| % e lejeve të lëshuara brenda afatit ligjore | 95 | 95 | 95 |
| Koha e nevojshme për lëshimin e certifikatës së inspektimit nga dita e kërkesës së qytetarit për lëshimin e certifikatës | 30 | 30 | 30 |

## 5.8. Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

**Misioni:** Siguron zbatimin e ligjeve dhe vendimeve tjera të aplikueshme, bën përgatitjen dhe hartimin e akteve të përgjithshme normative të drejtorisë, përgatit Planin Strategjik të Zhvillimit të Bujqësisë, koordinon dhe kontrollon të gjitha sferat që kanë të bëjnë me bujqësi.

**Vizioni:** Qëllimi ynë kryesor është për të siguruar që numri maksimal i familjeve në zonat e fshatrave dhe sidomos fermat familjare do të zhvillohen dhe mbajnë një bazë ekonomike të qëndrueshme brenda komunës. Ne planifikojmë dhe t'a bëjmë këtë duke mbrojtur tokën bujqësore përmes mbajtjes së një shënimi/të dhënave të sakta të përdorimit të tokës bujqësore dhe pronësisë së këtyre pronave. Ne do të bashkëpunojmë me bankat komerciale, për të shqyrtuar format e kreditimit për fermerët, dhe për të stimuluar dhe promovuar blerjet blegtoriale dhe zhvillimin bujqësor në këto mjedise. Ne gjithashtu do të ofrojmë mbështetje veterinare për fermerët për të reduktuar sëmundjet në blegtori. Ne do të promovojmë mbrojtjen e mjedisit tonë natyror dhe të zbatojmë legjislacionin përkatës në fushën e mjedisit dhe ruajtjes së pyjeve.

**Performanca:**

| Indikatori | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|
| % e tokës bujqësore që është duke u kultivuar | | | |
| Miser | 20 | 25 | 25 |
| Jonxhe dhe tjera | 35 | 35 | 35 |

## 5.9. Drejtoria e Arsimit

**Misioni:** DKA ushtron funksionet dhe përgjegjësitë e saj në bazë të ligjit lidhur me organizimin e arsimit për nxënës vajza dhe djem. Nxit barazinë me mundësinë për të ndjekur arsimin në të gjitha nivelet e komunës, gjithëpërfshirje në arsim, në zhvillimin dhe aftësimin e personelit për mësim sa më cilësor.

**Vizioni:** Qëllimi ynë është që të sigurojmë qasje të barabartë për të gjithë fëmijët brenda komunës, në sistemin e arsimit cilësor, parashkollor, fillor dhe atë të mesëm. Ne gjithashtu do të mbështesim sigurimin e edukimit të më tejmë për të rriturit. Për t'a bërë këtë, ne kemi siguruar zbatimin e rregullores kombëtare dhe legjislacionit të duhur arsimor, dhe politikat gjegjëse si rezultat.

| Indikatori | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|
| % e fëmijëve që arrijnë moshën për të filluar shkollën | | | |
| % i nxënësve që kalojnë provimin shtetëror | 65 | 70 | 75 |
| % e shkollave që kanë kaluar nga sistemi me 3 ndërrime në sistemin me 2 ndërrime | | | |
| Raporti i numrit të mësuesve me numrin e fëmijëve parashkollorë, fillorë dhe të mesëm. | 1/15 | 1/15 | 1/15 |

## 5.10. Drejtoria e Ekonomi dhe zhvillim

**Misioni:** Arritja e niveleve më të larta të ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit në menaxhimin e burimeve komunale.

**Vizioni:** Nëpërmjet planifikimit të duhur dhe menaxhimit të resurseve komunale, ne përpiqemi që të promovojmë vlerën për ofrimin e të gjitha shërbimeve për qytetarët e Deçanit. Ne e mbikëqyrim planifikimin dhe zbatimin e buxhetit komunal për të siguruar pajtueshmërinë me të gjithë legjislacionin e financave, statutit dhe rregulloreve tjera përkatëse. Ky veprim përfshin zbatimin e rregullores mbi tarifat dhe pagesat, veprime që lidhen me mbledhjen e tatimit në pronë. Ne gjithashtu do i përgatisim të gjitha raportet financiare dhe llogaritë vjetore në përputhje me kërkesat statutore komunale. Përveç kësaj, ne punojmë për të nxitur zhvillimin ekonomik në gjithë komunën, duke krijuar një "partneritet" me komunitetin e biznesit dhe hartimin e planeve, por me theks të veçantë, për zhvillimin e NVM-ve.

| Indikatori | 2025 | 2026 | 2027 |
|---|---|---|---|
| Numri i dokumenteve financiare të | | | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| publikuara në faqen e internetit të komunës brenda 1 jave pas miratimit | | | |
| Numri i bizneseve të reja që kanë filluar punën | 10 | 15 | 20 |
| Numri i vendeve të reja të punës që janë krijuar | 20 | 30 | 40 |
| | | | |

### 5.11. Drejtoria për Inspeksion

**Misioni:** Që të zhvillojë dhe të sigurojë me efektivitet dhe efikasitet:
- kushtet higjieno - sanitare dhe teknike në ambientet ku jetojnë qytetarët e Deçanit, ku punojnë, edukohen, shërohen, argëtohen etj.;
- normat dhe standardet e operatorëve që kryejnë veprimtari ligjore nga kompetenca e kësaj drejtorie;
- implementimin e masave dhe programeve preventive, përmes zhvillimit dhe forcimit të inspektimeve kompetente ligjore.

**Vizioni:** Vizioni i DI-së është mbrojtja e konsumatorit, mbrojtja e shëndetit publik, mbikqyrja dhe aplikimi i ligjeve për planin zhvillimor, rregullues dhe urbanistik, përmes inspektimeve, vendimeve, pëlqimeve, evidentimeve dhe ndërmarrjes së masave ligjore ndaj subjekteve – operatorëve që kryejnë veprimtari joligjore nga kompetenca e kësaj drejtorie, duke siguruar kushte dhe ambient të shëndoshë për qytetarët e Deçanit.

**Qëllimi:** Mbikëqyrja dhe aplikimi i ligjeve dhe akteve të tjera ligjore në fushën e ndërtimit, tregut sanitar, veterinarisë, bujqësisë, mbrojtjes së ambientit, trafikut urban - komunikacionit, hidroekonomisë, rrugëve etj. Promovimi i kushteve higjieneo - sanitare dhe teknike në institucionet publike dhe private. Zhvillimi i resurseve humane dhe forcimi i llogaridhënies.

### 5.12. Drejtoria për Kultur Rini e Sport

**Misioni:** Në kuadër të kompetencave dhe përgjegjësive të Drejtorisë janë:
- avancimi i përgjithshëm i vlerave kulturore, kombëtare dhe sportive;
- shënimi i përvjetorëve të përsonaliteteve të kulturës dhe historisë kombëtare, të të gjitha kohërave;
- formimi i shoqërive kulturo - artistike, grupeve dhe ekipeve sportive;
- përkrahja e talenteve të reja, në veçanti krijimi i kushteve për zhvillimin e veprimtarive kulturo - artistike dhe sportive;
- prezantimi i denjë i komunës në nivel vendi dhe më gjerë;
- kujdesi dhe mirëmbajtja e institucioneve të kulturës, rinisë dhe sportit dhe ndërtimi i objekteve të reja;
- nxitja e bashkëpunimit me shoqëritë kulturo - artistike, me grupet rinore dhe ekipet sportive në nivel vendi dhe më gjerë;

- ngritja e vetëdijes njerëzore në aspektin e dashurisë dhe humanizmit;
- nxitja dhe përkrahja e krijuesëve të fjalës artistike;
- botimi i veprave me vlera kulturore e historike kombëtare;
- shtrirja e aktivitetit të sektorit të sportit edhe në shkollat e komunës, me qëllim të zbulimit e të ndihmës së talenteve të reja në fushën e kulturës e të sportit, organizimi i garave në nivel komune, rajoni, vendi e më gjerë.

### 5.13. Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadaster

<u>**Misioni:**</u> Drejtoria është përgjegjëse për:
- zhvillimin dhe organizimin e kapaciteteve kadastrale;
- rrjetin referues homogjen;
- rikonstruktimin e informatave kadastrale në formë digjitale;
- modelin e sistemit informativ për tokën dhe pronën;
- ofrimin e shërbimeve profesionale dhe shërbimeve të tjera për subjekte të interesuara, përmirëson transferimin e tokës, menaxhimin e tokës shtetërore dhe efikasitetin në tatimin e tokave;
- planifikon rrjetin me pika të reja kontrolluese dhe themelon pika të reja kontrolluese; digjitalizon pikat poligonale dhe trigonometrike, vektorizimin e planeve të skanuara (ngastrave dhe zonave kadastrale);
- azhurnon pjesën grafike, në bazë të dokumenteve dhe matjeve të reja dhe i transformon me parametrat e dhëna për transformim;
- ofrimin e shërbimeve rreth mirëmbajtjes dhe klasifikimit të kulturave të tokës.